



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE GJILAN

Numri i lëndës: 2023:120954

Datë: 05.06.2024

Numri i dokumentit: 05784206

P.nr.386/2023

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN, Departamenti i Përgjithshëm, përmes gjyqtarit të vetëm gjykues Veli Kryeziu, me bashkëpunëtoren profesionale Vlora Selmani-Rahimi, në lëndën penale ndaj të pandehurës S... S.... nga Gjilani, për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 1 nënparagrafi 3.2 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Departamenti i Përgjithshëm në Gjilan, PP.II.nr.752/2023, të datës 29.05.2023, pas mbajtjes së shqyrtimit fillestar dhe jopublik, më datën 31.05.2024, publikisht shpalli, ndërsa më datë 04.06.2024, përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

Ndaj të pandehurit: S... S..., nga babai Rr. nëna F., e gjinisë D, e lindur me datë . në fshatin Lajqiq, komuna Kamenicë, me vendbanim në Gjilani, rruga „.....”, numër , me vendqëndrim në Z, e martuar, nënë e katër fëmijëve, me gjendje të mirë, me nr. personal...., shqiptare, shtetase e Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTORE

S E P S E

Me datë 03.05.2023, rreth orës 03:00, në Gjilani, rruga „...”, në shtëpinë e përbashkët familjare, e pandehura, ka ushtruar dhunë në familje, ndaj bashkëshortit të tij Halil Spahiu, në kundërshtim me nenin 2, nën paragrafi 1.2 të Ligjit për Dhunë në Familje, duke ushtruar dhunë fizike dhe psikike, në atë mënyrë që, pas një mosmarrëveshje mes vete, e njëjta fillimisht ka filluar të ofendojë, me fjalët: „ju pisat e keni rrit këtë k...rvar edhe fëmijët i ka k...var, je i falt”, pastaj, e ka goditur me dorë duke ia këputur rruzat në qafë, me ç’rast, kanë ndërhyrë vajzat dhe e kanë larguar nënën e tyre, me çka e pandehura, pos që ka cënuar rëndë dinjitetin e të dëmtuarit, ka shkaktuar edhe ankth dhe shqetësim të madh emocional.

-Me çka ka kryer veprën penale, **dhunë në familje, nga neni 248 paragrafi 1, nën paragrafi 3.2 të KPRK-së;**

Andaj, gjykata në bazë dispozitës së lartcekur ligjore si dhe neneve, 4,7,17,38,39,40,42,43,44,69,70,71,72, si dhe nenit 364 të Kodit Procedurës Penale të Republikës së Kosovës, të pandehurën S... S.....:

E g j y k o n

Me dënim me burgim në kohëzgjatje prej njëqindë e njëzet(120)ditësh si dhe dënim me gjobë në shumë prej njëqindë e pesëdhjetë euro(150€),të cilat dënime me pëlqimin e të pandehurës në kuptim të nenit 44 të KPRK-së, **I ZËVËNDSOHEN në dënim me gjobë** në shumë prej **tetëqind e pesëdhjetë euro (850)euro**, të cilën shumë duhet ta paguaj në 2 këste të barabarta duke filluar nga dita pasuese e plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi.

Mirëpo, nëse eventualisht e pandehura nuk dëshiron ose nuk mund ta paguaj dënimin me gjobë në kuptim të nenit 43 paragrafi 3 të KPRK-së të njëjtës i zëvendësohet me dënim me burgim duke ju llogaritur çdo 20 euro të barabartë me 1 (një) dite burgimi. ose në mënyrë për pjesëtimore me pjesën e dënimit të gjobës së pa paguar, të cilin dënim duhet ta filloj ta mbaj ne afat prej 15 ditëve nga dita pasuese e pranimit të ftesës nga gjykata.

I dëmtuari Halil Spahija nga Gjilani, rruga “Xh.. K...”, për realizimin e kërkesës pasuroro juridike udhëzohet në kontest civil.

Obligohet e pandehura që të paguaj shpenzimet e procedurës penale dhe paushallin gjyqësor në shumën prej njëzetë (20) euro si dhe taksa për kompensimin e viktimave të krimit, në shumën prej tridhjetë (30) euro, secila e në bazë të nenit 39 paragrafi 3, nën paragrafi 1.3 të Ligjit për Kompensimin e Viktimave të Krimit, në afat prej 15 ditësh pas plotëfuqishmërisë së këtij aktgjykimi, nën kërcënimin e përmbarimit të dhunshëm.

A r y e t i m

1. Historiku i procedurës

Prokuroria Themelore në Gjilan, Departamenti i Përgjithshëm, më datë 29.05.2023, ka ngritur aktakuzën e lartcekur, ndaj të pandehurës S... S... nga Gjilani, për shkak të veprës penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 1 nënparagrafi 3.2 të KPRK-së.

Në shqyrtimin fillestar të datës 31.05.2024, ishin prezent Prokurorja e Shtetit, e pandehura Selvete Spahija.Në të cilën seancë e pandehura pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurores së shtetit, deklarohet se e ka kuptuar në tërësi aktakuzën dhe veprën penale për të cilën akuzohet dhe se e pranon fajësinë për kryerjen kësaj vepre penale. Po ashtu për këtë pranim janë pajtuar edhe prokurorja e shtetit.

2. Vlerësimi i pranimit të fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor dhe publik, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të prokurores të shtetit, ka marrë aktvendim me të cilin ka pranuar fajësinë e të pandehurës, për kryerjen e veprës penale për të cilën akuzohet, ngase ka konstatuar se janë plotësuar gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se e pandehura e ka kuptuar drejtë natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht se i pandehura nuk ka qenë e detyruar ose i shtrënguar në asnjë mënyrë që të pranojë fajësinë, se pranimi i fajësisë mbështet në faktet e çështjes të cilat i përmban aktakuza dhe se aktakuza nuk përmban ndonjë shkelje ligjore e as gabime faktike gjithnjë duke u konsultuar me mbrojtësin e tij.

3. Gjendja faktike e vërtetuar

Andaj, duke u bazuar në këto që u cekën më lart, gjykata e ka vërtetuar këtë gjendje faktike, duke u bazuar në format e kualifikuara të kësaj vepre, ekziston fakti se i pandehur Selvete Spahija ka kryer veprën penale dhunë në familje nga neni 248 paragrafi 1 nënparagrafi, në kohën, vendin, dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

4. Elementet e veprës penale

Gjykata, pas dëgjimit të deklaratave të palëve dhe të mbrojtësit lidhur me dënimin, e ka shpallur fajtor të akuzuarin nga Gjilani, për shkak të veprës penale lëndim i lehtë trupor nga neni 185 paragrafi 3 nënparagrafi 3.1 i KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtës i përmbajnë të gjitha tiparet e veprës penale dhe se për të njëjtën është dhe penalisht përgjegjës. Kjo për faktin se e njëjta e ka pranuar edhe vet veprën penale e cila i vihet në barrë.

5. Rrethanat që janë marrë për bazë me rastin e shqiptimit të dënimit

Gjykata, me rastin e shqiptimit të dënimit me burg, ka vlerësuar se duke i marrë për bazë të gjitha rrethanat e shënuara më poshtë, të cilat duke i ndërlidhur njëra me tjetrën, janë vlerësuar rrethana posaçërisht lehtësuese, ky dënim do të jetë një dënim i drejtë dhe në harmoni me peshën e veprës penale. Me rastin e matjes së dënimit e të pandehurës, gjykata ka marrë për bazë të gjitha rrethanat që ndikojnë në llojin dhe lartësinë e dënimit, të parashikuara në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, Kështu, si rrethanë posaçërisht lehtësuese, mbi bazën e së cilës gjykata e ka zbutur dënimin dhe ndaj të pandehurit ka shqiptuar dënim, se e pandehura ka bashkëpunuar me prokuroren e shtetit, pranimin e fajësisë e ka bërë në shqyrtim fillestar se e pandehura është penduar thellë për kryerjen e kësaj vepre penale, tani jetojnë bashkë me të dëmtuarin kanë raporte të mira bashkëshortore dhe më asnjëherë nuk kanë pas probleme, po ashtu e njëjta i ka premtuar se nuk do të kryej vepra tjera penale, ka pas sjellje korrekte gjatë shqyrtimit dhe fakti që nuk ka qenë e dënuar më parë për ndonjë vepër penale të kësaj natyre. Këto janë rrethana, që tregojnë se edhe me një dënim më të butë mund të arrihet qëllimi i dënimit dhe e pandehura me të drejtë mund të pritët që në të ardhmen nuk do të kryej vepra tjera penale. Ndërsa, rrethanë rënduese është se e pandehuri me dashje, ka kryer veprën penale, rrethanat e kryerjes së veprës penale ku pas një mosmarrëveshje mes vete, e njëjta fillimisht kishte filluar të ofendoj, me fjalët: „ju pisat e kenë rrit këtë k...rvar edhe fëmijët i ka k...var, je i falt’’, pastaj, e ka goditur me dorë duke ia këputur rruzat në qafë, me ç’rast, kishin

ndërrhyrë vajzat dhe e kanë larguar nënën e tyre, me çka e pandehura, pos që ka cënuar rëndë dinjitetin e të dëmtuarit, ka shkaktuar edhe ankth dhe shqetësim të madh emocional.

6. Shqiptimi i dënimit në harmoni me peshën e veprës penale dhe me shkallën e përgjegjësisë penale të pandehurit dhe qëllimi i dënimit të shqiptuar

Gjykata, ka konstatuar se me dënim me burg, mund të arrihet edhe qëllimi i dënimit, nga neni 41 i KPRK, i cili konsiston në parandalimin e të pandehurit nga kryerja e veprave penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandalojë personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shprehë gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit. Gjyqtari i vetëm gjykues në kuptim të nenit 368 të KPP-së pas shpalljes së aktgjykimit ka dhënë një arsyetim të shkurtër lidhur me arsyet përmbledhëse për dënimin e shqiptuar dhe qëllimin që ka synim ta arrij tek e pandehura duke e disiplinuar të njëjtin por edhe qytetarët potencial që në të ardhmen mos të kryejnë vepra penale. Palët janë paralajmëruar për të drejtën në ankesë.

7. Vendimi për kërkesën pasuroro juridike

Duke u bazuar në nenin 462.2 të KPPK-së të dëmtuarin Halil Spahija për realizimin e kërkesës pasuroro juridike e udhëzoj në kontest civil.

8. Vendimi për shpenzimet e procedurës penale

Duke e pasur natyrën e kësaj çështje penale, gjykata, duke u bazuar në nenin 452 paragrafi 1 të KPP, ka vendosur që të pandehurin t'a detyrojë për ti paguar shpenzimet e procedurës penale, dhe paushallin gjyqësor, në afat prej 15 (pesëmbëdhjetë) ditëve, nga dita kur ky aktgjykim të bëhet i formës së prerë.

Duke u bazuar në këto që u cekën më lart, është vendosur si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË GJILAN
Departamenti i Përgjithshëm
Divizioni Penal
P.nr. 386/2023, më 31.05.2024

Bashkëpunëtoreshë Profesionale
Vlora Selmani-Rahimi

Gjyqtari i vetëm gjykues
Veli Kryeziu

KËSHILLA JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi mund të paraqitet ankesë në Gjykatën e Apelit në Prishtinë / Departamentit të përgjithshëm në afat prej 30 ditëve nga dita e pranimit e të njëjtit. Ankesa në kopje të mjaftueshme i paraqitet kësaj gjykate.